



**Datë:** 09.06.2025

**Numër Protokolli:** 3983/2025

**A.nr.606/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardit Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.606/2025, të datës 07.04.2025 të parashtruar nga ankuesi B.M, kundër organit të punësimit/ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike “*transferim pas ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet** si e pazuar ankesa me numër A.nr.606/2025, e datës 07.04.2025, e parashtruar nga ankuesi B.M.

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi Nr.R.MAPL704/2025, i datës 28.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.M (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 07.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.R.MAPL704/2025, i datës 28.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, lidhur me transferimin e tij pas ristrukturimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.04.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa kjo e fundit më datë 22.04.2024, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokolli 3199/2025, të datës 15.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.606/2025, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2284/2025 të datës 07.04.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr.R.MAPL704/2025, të datës 28.03.2025; Dokument identifikimi; E-mailin e datës 02.04.2025; Akt emërimit Ref.L-5/1;Vendimin e datës 21.03.2022; Vendimin e datës 03.06.2022; Vendimin e datës 12.10.2023; Vendimin e datës 08.04.2024; Vendimin e datës 28.03.2021; Vendimin e datës 27.11.2020; Vendimin e datës 10.07.2017; Kërkesën për pushim të lehonisë; Vendimin e datës 05.08.2015; Vendimin e datës 17.09.2018; Pagesa për periudhën 1-31.03.2025; E-mailin nga NARIC; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.04.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 22.04.2025; Vendimin V.nr.2565/2024 të datës 27.12.2024; Raportin me numër protokolli 648 të datës 24.03.2025; Dokument me shifër 01-326346 (në gjuhën serbe); Dokument me shifër 12/2017 i datës 24.08.2018 (në gjuhën serbe); Dokument me numër 0-102/21-06 i datës 28.06.2021; Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës të ankuesit, i datës 31.01.2022, datës 31.01.2023 dhe datës 31.01.2024; Vërtetimin e datës 18.04.2025; Vendimin me Nr.R.MAPL 732/2024 të datës 28.03.2025; Certifikatat e znj. L.B; Diplomën me Nr.624/13 të datës 16.08.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të komunës; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar për monitorimin e komunave; Akt emërimit Ref/MPL/160 të datës 20.01.2020; Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës, të datës 15.01.2023 dhe datës 19.02.2025; Vërtetimin e datës 18.04.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me Ref.L-5/1 të datës 26.09.2014, është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar Administrativ, në Departamentin Ligjor dhe Monitorim të Komunave pranë Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal.

Tutje sipas Vendimit me Nr.155/2024 të datës 30.08.2024 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.17/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me ç ‘rast procesi i organizimit të këtij institucioni, është pasuar me shuarje të pozitave, ndryshime në emërtime të pozitave përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave të punës dhe kërkesave të përgjithshme formale.

Në kuadër të përgjegjësiive ligjore, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Vendimin me V.nr.2565/2024, të datës 27.12.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, i cili më datë 24.03.2025 ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në këtë institucion, duke propozuar që ankuesi të ri caktohet sistemohet nga *Zyrtar Administrativ-Klasa Profesional 3*, në pozitën *Asistent Administrativ-Klasa Profesional 3*.

Si rrjedhojë, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datës 28.03.2025 ka nxjerr Vendim me Nr.R.MAPL 665/2025, me të cilin ankuesin nga pozita aktuale e Zyrtarit Administrativ pranë Departamentit Ligjor dhe Monitorimi i Komunave, e ka transferuar në pozitën Asistent Administrativ pranë Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Kryetarit të Komunës në kuadër të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se përmes vendimit të lartë theksuar i njëjti është degraduar nga niveli profesional 2 në nivelin e personelit ndihmës-teknik, duke theksuar se ky vendim është i padrejtë, diskriminues dhe në

kundërshtim me parimet e drejtësisë, si dhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi që rregullojnë pozitat e nëpunësve civil, duke theksuar se posedon diplomën universitare të fituar në Universitetin e Beogradit, e cila për shkaqe politike dhe administrative, e njëjta nuk është nostrifikuar, ndër të tjera pretendon se të gjithë zyrtarët tjerë nga Departamenti Ligjor janë avancuar në nivelin profesional 1, ndërsa i njëjti është degraduar, andaj kërkon rishqyrtimin e vendimit kontestues, shqyrtimin e bazueshmërisë së kriterëve të përdorura gjatë këtij procesi ashtu që të njëjtit ti mundësohet ri harmonizimi i statutit të tij me kualifikimet, arsimimin dhe përvojën në nivelin profesional 1.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësi përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësi/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësi përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësuese të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës...*

Po ashtu Kolegji ju referuar edhe Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, respektivisht nenit 12, ku përcaktohet: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Shuarja apo ristrukturimi i institucionit përcaktohet në legjisllacionin përkatës për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. 3. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 3.1. në të njëjtin institucion; 3.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë, apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 3.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 3.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 4. Transferimi bëhet sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni. Nëse nuk ka pozita të lira të së njëjtës kategori apo nëpunësi nuk plotëson kërkesat e pozitës së punës në të njëjtin institucion sipas nënparagrafit 3.1. të këtij neni, transferimi i tij mund të bëhet në institucionin tjetër sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3. 5. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar njoftohen individualisht nga NjMBNj për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit. Njoftimi bëhet menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit së institucionit”*.

Rrjedhimisht, bazuar në dispozitat e lartë theksuara ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se me hyrjen në fuqi të Rregullores (ZKM) Nr.17/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pasuar me shuarje të pozitave, ndryshime në emërtime të pozitave përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve të punës për pozita të caktuara, ndërsa pozita e ankuesit Zyrtar Administrativ-Klasa Profesional 3, me këtë rregullore është emërtuar Asistent Administrativ-Klasa Profesional 3, dhe atë si pozitë e vetme brenda Departamentit Ligjor, ashtu që duke marrë parasysh se ankuesi ka plotësuar kriteret e posaçme lidhur

me arsimimin, përvojën dhe kualifikimet, i njëjti me të drejtë sipas Komisionit të Ristrukturimit është propozuar të risistemohet në të njëjtën pozitë por me emërtim të ndryshuar, andaj si rrjedhojë edhe pretendimi ankimor i ankuesit se është degraduar në nivelin e nëpunësve ndihmës-teknik është i pa bazuar, ngase kjo pozitë pune në të cilën është transferuar apo risistemuar i njëjti, hynë në pozitë e shërbimit civil, e cila sipas Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i aprovuar me Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është renditur me nr.6 dhe me kodi SHC-0006, e vendosur në Grupin e administrimit të përgjithshëm, si dhe kërkesa arsimore është përcaktuar: Arsim i mesëm i paspecifikuar, ashtu siç është përcaktuara edhe me rregulloren e brendshme të organit përkatës të punësimit, gjegjësisht në Gr.64 Grupi i administrimit të përgjithshëm.

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se edhe pretendimi ankimor i ankuesit për ngritje në pozitë në klasën profesional 1, është i pa qëndrueshëm ngase i njëjti sipas shkresave të lëndës rezulton se nuk plotëson kërkesat e posaçme për ngritjen në pozitë apo kërkesës lidhur me kualifikimin arsimor, sepse nuk posedon Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), të njohur-nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë- Qendra për Njohje të Diplomave (NARIC), ku dhe vet ankuesi deklaron se diplomën e ka fituar në Universitetin e Beogradit, si dhe sipas shkresës elektronike zyrtare të NARIC, konstatohet se lidhur me diplomën e dorëzuar për njohje nga ankuesi, ende nuk ka ndonjë progres sepse nuk ka asnjë marrëveshje aktive mes Kosovës dhe Serbisë.

Kolegji i Këshillit mbi bazën e konstatimeve si më lartë, vlerëson së Komisioni i Ristrukturimit në rastin e ankuesit ka vepruar në pajtim me 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenet 13, 14 dhe 15 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, andaj, përkitazi me ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht kundër Vendimit me Vendimi Nr.R.MAPL 704/2025, të datës 28.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është nxjerr në pajtim me nenin 66 paragrafi 4 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe po ashtu ky vendim përmban elementet të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse akti i kundërshtuar me ankesë përmban dispozitiv të qartë dhe arsyetim konkret, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, ngase, në rastin konkret të ankuesit nuk janë cenuar parimet e sigurisë juridike në raport me marrëdhënien e tij të punës, ngase i njëjti është risistemuar në kategorinë dhe klasën e njëjtë, për të cilën plotëson kriteret e posaçme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.606/2025**

**Atdhe GASHI**

Procesmbajtës

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit B.M;
- Udhëheqëses së Njëjesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në MPB, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.